

Vendim nr. 72 datë 08.04.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, anëtarë, në datën 08.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Dh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DHIONISIOS ALFRED BELERI**, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i “arrestimit në flagrancë” i shtetasit Dhionisios Alfred Beleri, i kryer në datën 12.05.2023 nga Policia Gjyqësore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, si i papajtueshëm me nenet 27, pika 1 dhe 28, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 205, datë 13.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për pjesën që ka vlerësuar të ligjshëm “arrestimin në flagrancë” të shtetasit Dhionisios Alfred Beleri; nr. 23, datë 21.06.2023 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë; nr. 00-2023-1530, datë 26.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, pika 1, 28, pika 1, 42, pika 1, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri ka qenë kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Pas zhvillimit të tyre, me vendimin nr. 194, datë 16.05.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88 ka shpallur kërkuesin fitues dhe në vijim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, ka vendosur: “*Dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, të propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë fitojmë.”*”.

2. Ndërkohë, në datën 08.05.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka regjistruar një procedim penal për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”. Për dokumentimin e veprës penale, me autorizim të prokurorit, është lejuar përdorimi i metodës speciale të hetimit për veprime simuluese dhe për lejimin e përgjimit dhe vëzhgimit, autorët e dyshuar janë vënë nën vëzhgim dhe përgjim ambiental. Pas të dhënave të përfutuara përmes edhe këtyre veprimeve hetimore përgjatë datës 11.05.2023 deri në orën 23:17, oficeri i Policisë Gjyqësore, në datën 12.05.2023, ka kryer arrestimin në flagrancë edhe të kërkuesit si autor i dyshuar i veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal (KP). Po në këtë datë, prokurori ka paraqitur kërkesë për vlefësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të kërkuesit dhe caktimin ndaj tij të masës shtrënguese të sigurimit “Arresti në burg”.

3. Me vendimin nr. 205, datë 13.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*gjykata e rrethit Vlorë*), ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit, pasi janë respektuar kërkesat e neneve 251, 252 dhe 258 të Kodit të Procedurës Penale

(KPP) të analizuara në harmoni me njëra-tjetrën dhe ka caktuar për të masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Ajo gjykatë ka deklaruar edhe moskompetencën e saj lëndore, duke vendosur dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë (GJKKO e Shkallës së Parë), si gjykata kompetente. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 751, datë 29.05.2023, ka vendosur dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO e Apelit).

4. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 23, datë 21.06.2023, ndër të tjera, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 205, datë 13.05.2023 të gjykatës së rrethit Vlorë, me ndryshimet si vijon: *“Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të kryer nga Policia Gjyqësore ndaj kërkuesit, përmes aktit procedural “procesverbal për kapjen në flagrancë, datë 12.05.2023, ora 00:14. Konstatimin e paligjshëm të arrestimit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore ndaj kërkuesit, përmes aktit procedural “procesverbal për kapjen në flagrancë, datë 12.05.2023, ora 09:45”. Mospranimin e ankimit për pjesën tjetër të shkaqeve të parashtruara.”*. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, vendimi i gjykatës së rrethit Vlorë nuk qartësonte se cilin veprim procedural të Policisë Gjyqësore ka konsideruar për të konkluduar se arrestimi në flagrancë i kërkuesit është i vlefshëm. Për këtë arsye, gjykata e apelit ka rivlerësuar faktet e rezultuara nga provat e administruara në funksion të identifikimit të momentit kur Policia Gjyqësore ka realizuar dhe dokumentuar arrestimin në flagrancë të kërkuesit, në rrethanat kur ekzistonin dy akte procedurale të ndryshme të datës 12.05.2023, njëri për kapjen në flagrancë i orës 00:14 dhe tjetri për arrestimin në flagrancë i orës 09:45, duke arritur në përfundimin se i pari përfaqësonte ligjërisht veprimin e Policisë Gjyqësore për arrestimin e kërkuesit. Në vijim, sipas gjykatës së apelit, kërkuesi është arrestuar në orën 00:14, pra rreth 57 minuta pasi Policia Gjyqësore ka marrë dijeni për veprën penale të dyshuar të kryer. Në këtë kuptim, sipas saj, kjo kohë duhet të konsiderohet si ndjekje e Policisë Gjyqësore ndaj personit nën hetim dhe, për pasojë, arrestimi i tij është bërë në gjendjen e flagrancës, në përputhje me nenet 251, pika 1 dhe 252 të KPP-së. Për këto arsye, duke miratuar vendimin e gjykatës së rrethit Vlorë, GJKKO-ja e apelit ka saktësuar disponimin për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer nga Policia Gjyqësore ndaj kërkuesit pikërisht atë të dokumentuar përmes aktit procedural *“Procesverbal për kapjen në flagrancë, datë 12.05.2023, ora 00:14”*.

5. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1530, datë 26.09.2023, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara

nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit ka arsyetuar drejt kur ka vlerësuar se nuk ekziston një moment i kapjes së personit dhe një moment tjetër i arrestimit të tij në flagrancë, por ky moment është një i vetëm dhe është ai fillestari kur personi është kapur dhe, që, sipas terminologjisë së përcaktuar në kod, quhet se është arrestuar në flagrancë. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se në rastin konkret përmbushet kriteri i parashikuar në pikën 1 të nenit 252 të KPP-së dhe arsyetimi i gjykatës së apelit lidhur me zbatimin e parashikimeve të kësaj dispozite, për sa i përket gjendjes së flagrancës, është i drejtë.

6. Ndërkohë, përpara shqyrtimit të ankimit të kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së rrethit Vlorë edhe për vleftësimin e masës së arrestit në flagrancë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023, ka vendosur vazhdimin e zbatimit ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Vendimi është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023, vendim i cili më pas është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023. Ky proces është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

7. Në datën 10.01.2024, nëpërmjet përfaqësueses së zgjedhur me prokurë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit të kërkesës. Me vendimin e datës 01.03.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se i janë cenuar:

8.1. *Liria personale*, pasi arrestimi i tij në flagrancë është kryer në kundërshtim me nenet 27, pika 1 dhe 28, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 5, pika 1, të KEDNJ-së, duke i cenuar rëndë edhe dinjitetin. Në momentin e arrestimit, ai nuk ndodhej në asnjë nga përcaktimet e nenit 252 të KPP-së, në të cilin është parashikuar gjendja e flagrancës. Në momentin e kapjes, atij nuk i është komunikuar arsyeja dhe shkaqet e një veprimi të tillë. Madje as oficerët e Policisë Gjyqësore nuk kanë qenë në dijeni për arsyet për të cilat po kryenin veprimin e kapjes në flagrancë. Kapja e kërkuesit nuk është kryer në kushtet e flagrancës dhe është arbitrare. Nga provat që gjykatat kanë pasur në dispozicion për vlerësim,

rezulton se kërkuesi nuk ka qenë duke kryer ndonjë veprë penale në kohën e “kapjes së tij në flagrancë”, por ka qenë në lokal, nën vëzhgimin e policisë, e cila nuk ka konstatuar kryerjen e ndonjë veprë penale. Për të vlerësuar nëse janë zbatuar procedurat e parashikuara në ligj, është i nevojshëm vlerësimi i provave nga Gjykata në raport me nenin 255 të KPP-së, i cili përcakton veprimet që duhet të kryejë Policia Gjyqësore kur kryen arrestimin në flagrancë. Arrestimi i kërkuesit është kryer jo sipas rasteve të parashikuara nga ligji.

- 8.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore që kanë vlerësuar të ligjshme gjendjen e flagrancës janë mbështetur në aludime dhe jo në prova të ligjshme. Këto vendime janë të pabazuara në ligj dhe në prova. Ky standard është cenuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ai nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka interes të ligjshëm në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual. Kurse në drejtim të pasojave

negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale vendimi i kundërshtuar i ka kufizuar kërkuesit lirinë personale edhe pse për një kohë të shkurtër.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa u përket kritereve që duhet të plotësojë një vendim i ndërmjetëm në mënyrë që të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata ka përcaktuar se ai: (i) duhet që të ketë vendosur një kufizim mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) duhet të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se me vendimin e gjykatës së rrethit Vlorë nr. 205, datë 13.05.2023, përveç vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë është vendosur edhe caktimi i masës “Arresti në burg” për kërkuesin. Kjo e fundit është bërë objekt kontrolli dhe vlerësimi, në një proces të ndarë, nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ku, në përfundim, këto gjykata kanë vendosur se kufizimi i lirisë së kërkuesit ka qenë i ligjshëm. Në lidhje me atë proces kërkuesi ka vënë në lëvizje edhe gjykimin kushtetues individual në përfundim të të cilit Gjykata, me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për rrjedhojë, objekt i kërkesës në shqyrtim janë vetëm vendimet gjyqësore që kanë disponuar për masën e arrestit në flagrancë të kërkuesit.

14. Gjykata vëren se në çështjen objekt kontrolli, nga ana e kërkuesit është ngritur pretendimi se atij i është cenuar liria personale si rezultat i vendimit të gjykatave për *vleftësimin e arrestit në flagrancë*. Në situata të ngjashme, kur pretendimet për cenim të lirisë personale ngrihen për shkak të zbatimit të *masës së sigurimit të arrestit*, Gjykata ka pranuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndonëse ky lloj vendimi (për caktimin e masës së sigurimit të arrestit) është i ndërmjetëm, si përjashtim, ai do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, vendimet që vendosin masën e sigurimit të arrestit, duke qenë se lidhen me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke pasur si pikënisje qëndrimin e mësipërm, Gjykata vlerëson se edhe pretendimet për cenim të lirisë personale, si rezultat i vendimeve që vleftësojnë *arrestin në flagrancë*, t’ua nënshtrorj të njëjtave standarde dhe kriteret kushtetuese si në rastin e masës së sigurisë së arrestit, duke i konsideruar ato përfundimtare për efekt të kontrollit nga ana e Gjykatës.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, i cili ka vleftësuar si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit përmbush *kriterin e parë* për t’u konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi ai ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit, për sa kohë që ka vendosur për ligjshmërinë e një mase kufizuese të lirisë, që ka qenë në fuqi deri në caktimin ndaj tij të masës së arrestit. Gjithashtu, vendimi në fjalë është kundërshtuar nga kërkuesi në gjykatat më të larta, të cilat janë shprehur për pretendimet e tij, ndaj përmbushet edhe *kriteri i dytë*. Për sa i takon *kriterit të tretë*, masës së autonomisë së vendimit që ka vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë, neni 27, pika 2, shkronja “c”, i Kushtetutës parashikon se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Ndërsa sipas nenit 28 të Kushtetutës, personit të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij. Në zbatim të delegimit të neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës, arrestimi në flagrancë është detajuar në dispozitat e KPP-së, konkretisht nenet 251, 252 dhe 258 të këtij kodi, që parashikojnë se në cilat raste kryhet detyrimisht arrestimi në flagrancë, çfarë konsiderohet “gjendje flagrante” dhe afatin brenda të cilit organi i akuzës ka detyrimin të kërkojë vleftësimin e masës në gjykatën kompetente, nëse nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm të të arrestuarit. Gjykata vëren se

ndonëse në praktikën e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm vendimi për vleftësimin e ligjshmërisë së arrestit në flagrancë dhe vendimi për caktimin e masës së sigurisë të arrestit merren brenda dhe në përfundim të njëjtit proces, ky fakt nuk ndikon në shkallën e autonomisë që këto vendime kanë në raport mes tyre.

16. Edhe pse dispozitat kushtetuese dhe në vijim edhe ato procedurale penale parashikojnë garancinë e dërgimit të të arrestuarit përpara gjyqtarit brenda 48 orëve nga arrestimi në flagrancë dhe, më tej, të vleftësimit nga gjyqtari të ligjshmërisë së arrestit në flagrancë jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim, kjo masë, për sa kohë që në vetvete sjell një kufizim të lirisë së individit, konsiderohet se ka natyrë autonome, qoftë nga procesi gjyqësor për caktimin e një mase sigurimi, ashtu edhe nga procesi gjyqësor që shqyrton në themel (pa)fajësinë e tij. Për rrjedhojë, cenimi i lirisë personale i ardhur nga veprimet e kryera gjatë kësaj procedure, pavarësisht kohëzgjatjes së shkurtër të saj, nuk përthithet apo korrigjohet nga procesi i caktimit të masës së sigurimit.

17. Për sa më sipër, si dhe duke pasur parasysh se kërkuesi e ka kundërshtuar veçmas vendimin e vleftësimit të ligjshmërisë së arrestit në flagrancë deri në Gjykatën e Lartë, Gjykata vlerëson si ai (kërkuesi) e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 26.09.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 10.01.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

19. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar se atij i është cenuar liria personale, si dhe e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të shqyrtohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

20. Kërkuesi ka pretenduar se arrestimi në flagrancë është kryer në kundërshtim me nenet 27, pika 1, 28, pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 5, pika 1, të KEDNJ-së, pasi nuk gjendej në kushtet e flagrancës, sipas parashikimeve të nenit 252 të KPP-së, për rrjedhojë arrestimi i tij ka qenë arbitrar, pasi nuk ka qenë duke kryer ndonjë vepër penale në atë moment, por ka qenë në lokal, nën vëzhgimin e policisë, e cila nuk ka konstatuar kryerjen e ndonjë vepre penale. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar

se vendimet gjyqësore që kanë vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë janë mbështetur në aludime dhe jo në prova të ligjshme dhe, për më tepër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura prej tij në rekurs.

21. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*). Ndërsa, sipas nenit 28, pika 2, të Kushtetutës, personit të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, shkronja "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirim të tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

22. Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e "*ligjshmërisë*" të përcaktuar nga Konventa, i cili kërkon që ligji të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 39, datë 15.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kushtet, kriteret dhe procedurat për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Liria personale mbrohet edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, sipas të cilit "dyshimet e arsyeshme" për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto fakte nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel, si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, të cilat i përkasin një shkallë të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën

akuzohet. Ai nënkupton bindjen që krijohet në bazë të provave të marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat, në unitetin e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet (*shih vendimin nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është shprehur se nëse një person ndalohet në bazë të nenit 5, paragrafi 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së, “gjykata” duhet të jetë e autorizuar të shqyrtojë nëse ka ose jo prova të mjaftueshme për të krijuar një dyshim të arsyeshëm se individi ka kryer një vepër penale, pasi ekzistenca e një dyshimi të tillë është thelbësore nëse burgimi duhet të jetë “i ligjshëm” sipas Konventës (*shih Dimo Dimov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2020, § 70*). Nëse gjykata nuk jep arsyet e duhura ose jep vendime stereotipe të përsëritura që nuk japin përgjigje për argumentet e kërkuarit, kjo mund të passjellë një shkelje që cenon garancitë e nenit 5, paragrafi 4, (*shih G.B. dhe të tjerët kundër Turqisë, 2019, § 176*).

25. Gjithashtu, GJEDNJ-ja është shprehur se në rastin e një personi të ndaluar, sipas nenit 5, paragrafi 1, shkronja “c”, kërkohet zhvillimi i një seancë dëgjimore (*shih Nikolova kundër Bullgarisë [GC], 1999, § 58*). Mundësia që një i ndaluar të dëgjohet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi është një nga garancitë themelore të procesit (*shih Kampanis kundër Greqisë, 1995, § 47*), proces i cili duhet të jetë kontradiktor dhe të garantojë “barazinë e armëve” ndërmjet palëve (*shih Reinprecht kundër Austrisë, 2005, § 31; A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], 2009, § 204*). Çështja nëse gjykimi është bërë “brenda një afati të shpejtë” përcaktohet nën dritën e rrethanave të secilit rast (*shih Ilmseher kundër Gjermanisë [GC], 2018, § 252; Rehbock kundër Sllovenisë, 2000, § 84*) dhe afati konsiderohet nga momenti i paraqitjes së kërkesës deri në përcaktimin e ligjshmërisë së ndalimit, duke përfshirë këtu çdo ankim (*shih Sanchez-Reisse kundër Zvicrës, 1986, § 54; E. kundër Norvegjisë, 1990, § 64*). Në bërjen e një vlerësimi të tillë, rrethanat që duhen marrë parasysh përfshijnë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e autoriteteve vendase dhe të kërkuarit, çfarë paraqiste rrezik për këtë të fundit (*shih Ilmseher kundër Gjermanisë [GC], 2018, § 252*).

26. Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe konventore, vëren se mbrojtja që ofrojnë ato shtrihet edhe mbi rastet e heqjes së lirisë për personin që kapet në kryerje e sipër të një vepre penale apo menjëherë pas kryerjes së saj nga autoritetet ligjzbatuese. Në këto raste, Kushtetuta dhe, në zbatim të saj, KPP-ja, parashikojnë garancinë e shqyrtimit të ligjshmërisë së arrestit në flagrancë nga gjyqtari, i cili vendos paraburgimin ose lirimin, ashtu edhe të drejtën e ankimit.

27. Për sa i përket legjislacionit të zbatueshëm, në rastin në shqyrtim, në lidhje me arrestimin në flagrancë, KPP-ja në nenin 251, pika 1, përcakton se oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet. Sipas nenit 252 të KPP-së, që jep kuptimin e gjendjes së flagrancës, në të ndodhet personi që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga Policia Gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Ndërsa neni 258, pika 1, i KPP-së, ka përcaktuar detyrimin e prokurorit për të kërkuar vleftësimin e masës së arrestit në flagrancë në gjykatën e rrethit ku është kryer arrestimi, nëse brenda 48 orëve nga arrestimi nuk ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të personit të arrestuar. Kurse neni 259, pika 3, i KPP-së parashikon mundësinë e ankimit të vendimit të gjykatës.

28. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve do të vlerësojë nëse për heqjen e lirisë personale të kërkuesit ka pasur dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, nëse heqja e saj është bërë sipas procedurave të parashikuara nga ligji dhe nëse gjykatat që kanë vleftësuar masën e arrestimit në flagrancë, mbi bazën e ankimit të kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshmërisht nga pikëpamja kushtetuese vendimet e tyre në këtë drejtim.

29. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi ka kandiduar në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023. Duke pasur parasysh rrethanat e zhvillimit të hetimit përmes përgjimeve dhe vëzhgimeve ambientale nga ana e Policisë Gjyqësore, nën mbikëqyrjen e prokurorit, në datën 12.05.2023, dy ditë para ditës së caktuar për zhvillimin e zgjedhjeve, ai është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të KP-së.

30. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se arrestimi në flagrancë i kërkuesit ka qenë i ligjshëm, në respektim të kërkesave të neneve 251 dhe 252 të KPP-së, të analizuara në harmoni me njëra-tjetrën. Gjykata e shkallës së parë, pasi ka marrë në analizë kushtet dhe kriteret në kuptim të nenit 27 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së, ka vlerësuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova ose të elementit provues, pra të elementeve të mjaftueshme që i krijojnë bindjen gjykatës në drejtim të mundësisë së kryerjes së veprës dhe përgjegjësisë së personit që akuzohet për kryerjen e saj. Sipas saj, bazuar në provat në gjendjen që ndodhen ato, në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi dhe shtetasi P.K. mund të kenë kryer veprën penale të parashikuar

nga nenet 328 dhe 25 të KP-së, pasi dyshohet se kanë ofruar dhe kanë dhënë të holla me qëllim për të votuar “pro” kërkuesit, si kandidat për kryetar i Bashkisë së Himarës. Nga përmbajtja e provave, sipas asaj gjykate, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprave penale në ngarkim të tij, dyshim që nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrësi ezaures (*shih paragrafët 50 dhe 52 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

31. Mbi ankimin e kërkuesit, pasi ka identifikuar, sipas akteve procedurale të administruara, momentin e arrestimit të tij nga Policia Gjyqësore, gjykata e apelit ka vlerësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë të kryer përmes aktit procedural “*Procesverbal për kapjen në flagrancë, datë 12.05.2023, ora 00:14*”, duke vlerësuar se është pikërisht veprimi sipas këtij akti procedural ai që i ka kufizuar lirinë personale kërkuesit. Sipas asaj gjykate, në rastin konkret, duke pasur parasysh veprën penale për të cilën akuzohet kërkuesi, Policia Gjyqësore ka qenë në kushtet e arrestimit të detyrueshëm në flagrancë, sipas pikës 1 të nenit 251 të KPP-së, ndërsa ai është kapur vetëm pas 57 minutave nga momenti kur ajo ka marrë dijeni për veprën penale. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka vlerësuar se afati ligjor i veprimit të arrestimit në flagrancë dhe kryerja e veprimeve procedurale në kohë nga prokuroria dhe nga gjykata, sipas neneve 258 dhe 259 të KPP-së, është respektuar. Në lidhje me pretendimin e ngritur në ankimin e kërkuesit për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për përgjegjësinë penale dhe ekzistencën e faktit penal, gjykata e apelit ka vlerësuar se ato janë trajtuar dhe zgjidhur me vendimin e saj nr. 19, datë 01.06.2023, në procesin që lidhet me zbatimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit “Arresti në burg” (*shih paragrafët 69, 85-89 të vendimit të gjykatës së apelit*).

32. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1530, datë 26.09.2023, ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e përcaktuara nga neni 432 i KPP-së. Për sa u përket pretendimeve për vleftësimin e arrestit në flagrancë, ai kolegji ka vlerësuar se gjykata e apelit ka arsyetuar drejt kur ka vlerësuar se nuk ekziston një moment i kapjes së personit dhe një moment tjetër i arrestimit të tij në flagrancë, por ky moment është një i vetëm dhe është ai fillestari kur personi është kapur dhe, që, sipas terminologjisë së përcaktuar në kod, quhet se është arrestuar në flagrancë. Kolegji Penal ka vlerësuar se nuk rezulton as që të ketë pasur përkeqësim të pozitës së kërkuesit (*shih paragrafët 75, 78 dhe 81 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Kolegji Penal, gjithashtu, bazuar në parashikimet e neneve 251 dhe 252 të KPP-së, referuar kufirit maksimal të dënimit të parashikuar në nenin 328 të KP-së, ka vlerësuar se përmbushet kriteri i parashikuar në pikën 1 të nenit 252 të KPP-së dhe se arsyetimi i

gjykatës së apelit lidhur me zbatimin e parashikimeve të kësaj dispozite, për sa i përket gjendjes së flagrancës, është i drejtë. Kurse për sa i përket pretendimit të ngritur në rekurs për mungesën e arsytimit të vendimit të gjykatës së rrethit Vlorë, Kolegji Penal ka vlerësuar se kjo pjesë është korigjuar dhe plotësuar në vendimin e gjykatës së apelit, e cila, me të drejtë, ka konkluduar se, në rastin konkret, veprimi procedural që ka kufizuar lirinë personale është ai i dokumentuar në aktin procedural *“Procesverbal për kapjen në flagrancë”*, ndaj parashikimet e neneve 251 dhe 252 të KPP-së realizohen duke pasur parasysh këtë akt dhe veprim procedural (*shih paragrafët 82 dhe 84 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

33. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në standardet kushtetuese dhe konventore, evidenton se arrestimi në flagrancë i kërkuesit, që është një masë e parashikuar me ligj, është bërë, gjithashtu, duke respektuar procedurat e parashikuara nga KPP-ja dhe vleftësimi i kësaj mase është shqyrtuar nga gjykatat, të cilat kanë përcaktuar momentin dhe aktin mbi bazën e të cilit është bërë heqja e lirisë, duke dhënë edhe argumente në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të organeve ligjzbatuese. Si gjykata e rrethit Vlorë, ashtu edhe GJKKO-ja e Apelit kanë analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuesit, si dhe kanë analizuar dispozitat ligjore përkatëse të zbatueshme në atë rast, në raport me kushtet dhe kriteret për gjendjen e flagrancës, e cila ka sjellë edhe kufizimin e lirisë personale, duke arsyetuar vendimet e tyre, si për sa u takon pretendimeve të tij për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej tyre për ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale.

34. Në vijim, edhe Gjykata e Lartë, referuar pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs duke verifikuar dhe vlerësuar se vendimet që kanë vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe kufizimin e lirisë personale të kërkuesit janë të drejta. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se vleftësimi i arrestit në flagrancë të kërkuesit dhe kufizimi i lirisë personale të tij nuk rezulton të jetë bërë në kundërshtim me nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës, dispozitat e KEDNJ-në, jurisprudencën kushtetuese ose dispozitat ligjore në fuqi dhe se gjykatat e zakonshme kanë mbajtur parasysh garancitë e ofruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor në këtë drejtim, duke garantuar edhe respektimin e nenit 142, pika 1, të Kushtetutës, në lidhje me standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore.

35. Mbledhja e Gjyqtarëve, vëren, gjithashtu, se në kuptim të nenit 28, pika 2, të Kushtetutës, në rastin e kërkuesit janë respektuar edhe parashikimet kushtetuese që përcaktojnë afatin për t'u dërguar përpara gjyqarit dhe për të pasur një vleftësim të arrestit. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës

rezulton se kërkuesi është arrestuar në datën 12.05.2023 dhe brenda afatit 48-orësh ai është dërguar në gjykatë, e cila, po brenda afatit 48-orësh nga marrja e dokumenteve, me vendimin e datës 13.05.2023, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit. Po kështu, në kuptim të pikës 3 të nenit 28 të Kushtetutës, kërkuesit i është garantuar edhe e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi dhe për të pasur një shqyrtim gjyqësor ndaj pretendimeve të tij në drejtim të arrestimit në flagrancë. Rezulton se vendimi i gjykatës së rrethit Vlorë është shqyrtuar nga GJKKO-ja e Apelit, e cila, me vendimin nr. 23, datë 21.06.2023, e ka miratuar atë, ndërkohë që vendimi i kësaj të fundit ka mbetur i pacenuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-1530, datë 26.09.2023.

36. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

37. Në përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.¹

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

¹ Gjyqtare Sonila Bejtja ka votuar për kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare, pasi, në vlerësimin e saj, pretendimi për kufizimin e lirisë, sipas nenit 27 të Kushtetutës, i lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, referuar vendimit të Gjykatës së Lartë (paragrafi 81 i atij vendimi), nuk është haptazi i pabazuar, ndaj ai duhej të kishte marrë përgjigje në themel nga Gjykata.